

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7073
E hënë, 18 dhjetor 2023
Çmimi 0.50

Drejtesit e policisë vizitojnë familjen e Afrim Bunjakut: Policia do të jetë gjithmonë pranë jush | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", KRYETARI I DEGËS SË PDK-SË NË ZVICËR, RAGIP XHAKA | FAQE 4-5

NËSE BËHEM DEPUTET DO TË JEM URË LIDHËSE NË MES TË MËRGGATËS DHE KUVENDIT TË KOSOVËS

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Dega në Zvicër, Ragip Xhaka, ka dhënë një intervistë për gazetën "Epoka e re". Ish-i burgosuri politik dhe veprimtari i hershëm i çështjes kombëtare, njëherësh babai i dy sportistëve më të mirë shqiptarë, Granit dhe Taulant Xhaka, në këtë intervistë ka folur për karrierën sportive të djemve të tij, për aktivitetin politik të PDK-së në Zvicër, për zhvillimet politike në Kosovë, për Gjykatën Speciale, për qeverisjen e Kurtit dhe për opozitën. Ragip Xhaka e ka lënë mundësinë e hapur që në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të jetë pjesë e listës së PDK-së për deputet. "Për kandidimin tim të mundshëm do të vendoset në forumet e partisë. Por, nëse zgjedhem deputet, ju garantoj se do të jem një urë lidhëse në mes të mërgatës dhe Kuvendit të Kosovës", ka thënë Xhaka



INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (15)

JASHARËT E KANË BËRË ATË QË S'E KA BËRË ASKUSH GJER MË SOT!

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KOREJA E VERIUT DYSHOHET SE LËSHOI RAKETË BALISTIKE, AKUZON SHBA-NË PËR RRRITJE TENSIONESH | F. 2

SHKUMBIN DEMALIAJ, KANDIDAT I PAVARUR PËR KRYETAR TË DEÇANIT | F. 3

SERBËT E KOSOVËS UDHËTOJNË TË ORGANIZUAR DREJT KUTIVE TË VOTIMIT NË SERBI | F. 2

EKONOMI



NË VITIN 2024 DO TË BIE INFLACIONI NË KOSOVË, JODOMOSDOSHMERISHT EDHE ÇMIMET | F. 8

GËRXHALIU: BUXHETI PËR VITIN 2024, MË SHUMË ZGJEDHOR SESA ZHVILLIMOR | F. 8

SPORT



KOSOVA RRËMBEN NJË MEDALJE TË ARTË DHE TRI TË BRONZTA NË KAMPIONATIN EVROPIAN | F. 10

Serbët e Kosovës të organizuar udhëtojnë drejt kutive të votimit në Serbi

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Në Serbi janë mbajtur të dielën zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, lokale e krahinore. Shumë qytetarë serbë të Kosovës janë nisur në orët e hershme të së dielës drejt Serbisë për të votuar në këto zgjedhje. Nga Graçanica u nisën disa autobusë, por

numri më i madh i serbëve të Kosovës, që të organizuar u nisën për të votuar, ishte nga komunat veriore, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Serbia ka mbajtur të dielën zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, lokale e krahinore. Të drejtë vote kanë

pasur rreth 6.5 milionë banorë. Qendrat e votimit kanë qenë të hapura prej orës 07:00 deri në orën 20:00, përveç rasteve ku ka pasur radhë të votuesve duke pritur në qendrat e votimit. Deri në orën 18:00 kanë votuar 51.93 për qind e qytetarëve.



Ndihmat në Gazë hyjnë përmes pikës kufitare me Izraelin për herë të parë prej nisjes së luftës

GAZA, 17 DHJETOR - Pika kufitare në mes të Izraelit dhe Gazës, Kerem Shalom, është hapur të dielën për kamionët me ndihma, për herë të parë që prej shpërthimit të luftës, kanë thënë zyrtarët izraelitë, me qëllim të dyfishimit të sasisë së ushqimit dhe ilaçeve në enklavë. Kjo pikë kufitare është mbyllur pas sulmeve të Hamasit në tokën izraelite, më 7 tetor, çka e ka nxitur luftën.

Militantët e Hamasit kanë vrarë 1 200 njerëz dhe kanë marrë peng 240 të tjerë.

Hamasit, grup palestinez që udhëheq Gazën, është shpallur organizatë terroriste prej Shteteve të Bashkuara



dhe Bashkimit Evropian.

Deri më tani ndihmat në Gazë kanë hyrë përmes pikës kufitare me Egjiptin, Rafah.

Dy burime të Kryqit të Kuq në

Egjipt i kanë thënë agjencisë "Reuters" se kamionët kanë nisur të hyjnë prej Kerem Shalomit në Gazë.

Njëri prej tyre ka thënë se

bëhet fjalë për 79 kamionë me ndihma.

Kerem Shalom, në kufi me Egjiptin, Izraelin dhe Gazën, është një prej pikave kyçe për transit mallrash prej dhe jashtë Gazës.

Izraeli është thënë se e ka miratuar hyrjen e ndihmave qysh prej javës së kaluar.

Megjithatë, autoritetet izraelite kanë thënë se ndihma humanitare mund të mos arrijë te banorët e Gazës, pasi agjencitë humanitare në Gazë nuk e kanë rritur kapacitetin për të shpërndarë ndihmën e nevojshme. "Nëse Kombet e Bashkuara nuk kanë kapacitet për të mbledhur dhe shpërndarë, nuk ka rëndësi sa

pika hapen. Ata nuk mund të varen prej mekanizimit të njëjtë që e kanë pasur para luftës", ka thënë koloneli Elad Goren për agjencinë "Reuters". Ofensiva ushtarake ajrore dhe tokësore e Izraelit në Gazë ka rezultuar me mbi 18 700 palestinezë të vrarë, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze.

Kjo fushatë ushtarake ka përkeqësuar rëndë situatën humanitare, pasi mbi 85 për qind e 2.3 milionë banorëve të Gazës janë shpërngulur prej shtëpive të tyre dhe po jetojnë në kampe të improvizuara. Ata po vuajnë nga mungesa e ushqimit, ujit të pijshëm dhe ilaçeve.

Koreja e Veriut dyshohet se lëshoi raketë balistike, akuzon ShBA-në për rritje tensionesh

Pyongyang, 17 dhjetor - Koreja e Veriut e ka lëshuar një lloj të paidentifikuar të raketës balistike, kanë thënë Garda Bregdetare e Japonisë dhe ushtria e Koresë së Jugut. Pak pas lansimit, vetë Pheniani e ka dënuar atë që e ka konsideruar shpërfaqje të forcës ushtarake, në krye me Shtetet e Bashkuara, dhe ka aluduar se veprimet e saj të fundit janë "paralajmërim për një luftë bërthamore".

Raketa është lëshuar drejt brigjeve lindore të Koresë së Veriut, sipas autoriteteve jugkoreane.

Rreth 20 minuta pas lansimit Garda japoneze ka thënë se

raketa ka rënë në det.

Ky lansim është bërë pas paralajmërimeve nga zyrtarë në Seul dhe Tokio që Koreja e Veriut - fuqi bërthamore - është duke u përgatitur për lëshim të një raketë - përfshirë një raketë balistike interkontinentale, këtë muaj.

Të gjitha aktivitetet me raketa balistike të verikoreanëve janë të ndaluara, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Mirëpo Pheniani i konsideron ato si të drejtë sovranë e një shteti për t'u vetëmbrojtur.

Rreth gjysmë ore pas lansimit, media shtetërore verikoreane e ka transmetuar një deklaratë të



Ministritë së Mbrojtjes, e cila i ka kritikuar "gangsterët ushtarakë" në Shtetet e Bashkuara dhe Korenë e Jugut për rritje të

tensioneve, përmes stërvitjeve, shpërfaqjes së forcës dhe planifikimit të një lufte bërthamore.

Në deklaratë është cituar arrija e një nëndetëseje amerikane me kapacitet bërthamor, USS Missouri në portin jugkorean, Busan, të dielën. "Forcat e armatosura të Koresë së Veriut do t'i neutralizojnë përpjekjet e ShBA-së dhe forcave të tyre vasale për të nisur luftë bërthamore, dhe kështu do të garantojnë paqe dhe siguri në Gadishullin Korean", është thënë në deklaratë.

Në deklaratë është kritikuar edhe mbajtja e një takimi në mes të ekipeve jugkoreane dhe amerikane të premtën në Uashington, duke thënë se veprime të tilla shërbejnë si paralajmërim për Korenë e Veriut.

Serbët e Kosovës të organizuar udhëtojnë drejt kutive të votimit në Serbi



PRISHTINË, 17 DHJETOR - Në Serbi janë mbajtur të dielën zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, lokale e krahinore. Shumë qytetarë serbë të Kosovës janë nisur në orët e hershme të së dielës drejt Serbisë për të votuar në këto zgjedhje. Nga Graçanica u nisën disa autobusë, por

numri më i madh i serbëve të Kosovës, që të organizuar u nisën për të votuar, ishte nga komunat veriore, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Serbia ka mbajtur të dielën zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, lokale e krahinore. Të drejtë vote kanë

pasur rreth 6.5 milionë banorë. Qendrat e votimit kanë qenë të hapura prej orës 07:00 deri në orën 20:00, përveç rasteve ku ka pasur radhë të votuesve duke pritur në qendrat e votimit.

Deri në orën 18:00 kanë votuar 51.93 për qind e qytetarëve.

Maqedonci takon në Nju-Jork kryesinë e Shoqatës Shqiptare-Amerikane të Zbatimit të Ligjit

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, u takua me kryesinë e Shoqatës Shqiptare-Amerikane të Zbatimit të Ligjit.

Ministri Maqedonci me kryetarin e kësaj shoqate, Elton Shametaj, patën një diskutim vëllazëror dhe shumë konstruktiv. Ata

diskutuan për situatën e sigurisë, zhvillimet në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe zbatimit të ligjit, angazhimin e bashkatdhetarëve në institucionet e zbatimit të ligjit në ShBA, si dhe mundësitë e bashkëpunimit.

Kryetari i shoqatës dhe anëtarët e kryesisë shprehën gatishmërinë e plotë për t'i mbështetur institucionet e

Kosovës dhe u zotuan për promovim sa më efektiv të të arriturave të institucioneve të sigurisë dhe zbatimit të ligjit të Kosovës në komunitetin e zbatimit të ligjit në ShBA.

Shoqata Shqiptare - Amerikane e Zbatimit të Ligjit mbledh qindra bashkatdhetarë që punojnë në institucione të zbatimit të ligjit në ShBA.



Drejtnesit e policisë vizitojnë familjen e Afrim Bunjakut: Policia do të jetë gjithmonë pranë jush

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, bashkë me stafin e tij, të dielën vizitoi pikëkalimin kufitar në Jarinjë, si dhe familjen e rreshterit policor Afrim Bunjaku, i cili më 24 shtator 2023 ra heroikisht në kryerje të detyrës në mbrojtje të vendit, integritetit dhe sovranitetit territorial të Republikës së Kosovës.

Në emër të Policisë së Kosovës drejtori Hoxha edhe njëherë gjatë kësaj vizite falënderoi familjen e heroit Bunjaku për sakrificën dhe kontributin e dhënë për shtetin e Kosovës, me ç'rast i siguroi ata se Policia e Kosovës do të jetë gjithmonë

pranë tyre duke kujtuar heroizmin e Afrimit dhe duke ofruar përherë mbështetjen e nevojshme për familjen e tij.

Familjes Bunjaku nga drejtori Hoxha iu dorëzua edhe një pllakate me emrin e heroit rreshter Afrim Bunjaku, e cila ishte dhuruar nga Shoqata shqiptaro-amerikane (AALEA US) e dedikuar për heroin e Kosovës. "Policia e Kosovës do ta kujtojë përherë heroin Afrim Bunjaku dhe të gjithë heronjtë e tjerë të cilët nuk kursyen as jetën e tyre për qytetarët dhe vendin. Ndërsa gjatë vizitës në pikëkalimin kufitar Jarinjë, takoi nga afër zyrtarët policorë të cilët i falënderoi për punën dhe angazhimin e tyre të pakursyer dhe njëkohësisht kërkoi nga ta të vazhdojnë me përkushtim



realizimin e detyrave policore në interes të sigurisë, parandalimit

të krimit e kontrabandës dhe menaxhimit sa më efikas të

kufirit shtetëror", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Shkumbin Demaliaj, kandidat i pavarur për kryetar të Deçanit



PRISHTINË, 17 DHJETOR - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, zyrtari i AAK-së, Shkumbin Demaliaj, ka njoftuar se do të jetë kandidat i pavarur për kryetar të Deçanit në zgjedhjet e ardhshme lokale. "Ju njoftoj se nga sot jam kandidat i pavarur për kryetar të Komunes së Deçanit", ka shkruar ai në "Facebook".

Demaliaj ka dhënë edhe arsyetimin e kandidimit si i pavarur. "Arsyetim: Duke parë se pushteti aktual qeverisës në Komunën e Deçanit është i

infektuar deri në palcë dhe Aleanca në Deçan ka dalë nga binarët e saj dhe pakënaqësia qytetare është ekstremisht e lartë!! Ne veç kemi biseduar bashkë për këtë të dashur qytetarë!! Andaj edhe kur më keni pyetur se nëse e kam me të vërtetë? Unë sot po ju them se përfundimisht e kam me të vërtetë dhe do të jem pranë jush deri në finale kur do ta përmbysim këtë klikë qeverisëse dhe do ta kthejmë AAK-në në binarët e saj dhe meritokracia dhe transparenca

do të mbizotërojë në qeverisjen lokale në Deçan", ka shkruar Demaliaj, duke bërë me dije se në zgjedhjet lokale 2025 do të garojnë edhe me listë zgjedhore për asamble komunale. "Ndërsa në zgjedhjet qendrore do ta mbështesim të gjithë Ramush Haradinajn dhe programin e tij nacional për qeverisje. Unë për të qenë sa më pranë jush nuk do të jem kandidat për deputet në zgjedhjet qendrore", ka shkruar Demaliaj.

Katër persona të vdekur në aksidente rrugore

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Policia e Kosovës ka bërë me dije se katër persona kanë vdekur të shtunën si pasojë e aksidenteve rrugore në Kosovë.

Tre persona kanë vdekur në autostradën "Ibrahim

Rugova", ndërsa një tjetër në fshatin Zajm të Klinës.

Në raportin 24-orësh të policisë është thënë se tre personat e vdekur në autostradë janë goditur nga shoferi i një makine dhe tre të tjerë janë plagosur.

I dyshuari është dërguar në mbajtje.

Mediet lokale në Kosovë kanë raportuar se tri viktimat në autostradë kanë qenë tre djem të rinj të cilët kanë shikuar një garë me makina.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, KRYETARI I DEGËS SË PDK-SË NË ZVICËR, RAGIP XHAKA

Nëse bëhem deputet do të jem urë lidhëse në mes të mërgatës dhe Kuvendit të Kosovës

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Dega në Zvicër, Ragip Xhaka, ka dhënë një intervistë për gazetën “Epoka e re”. Ish-i burgosuri politik dhe veprimtari i hershëm i çështjes kombëtare, njëherësh babai i dy sportistëve më të mirë shqiptarë, Granit dhe Taulant Xhaka, në këtë intervistë ka folur për karrierën sportive të djemve të tij, për aktivitetin politik të PDK-së në Zvicër, për zhvillimet politike në Kosovë, për Gjykatën Speciale, për qeverisjen e Kurtit dhe për opozitën. Ragip Xhaka e ka lënë mundësinë e hapur që në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të jetë pjesë e listës së PDK-së për deputet. “Për kandidimin tim të mundshëm do të vendoset në forumet e partisë. Por, nëse zgjedhem deputet, ju garantoj se do të jem një urë lidhëse në mes të mërgatës dhe Kuvendit të Kosovës”, ka thënë Xhaka

EPOKA E RE

Sadik ZEQRIRI

PRISHTINË, 17 DHJETOR -

“Epoka e re”: Z. Xhaka, jeni babai i Taulantit dhe Granitit, dy futbollistëve ndër më të mirët që njohin shqiptarët. Si e ndieni veten kur takoheni me simpatizuesit e djemve tuaj?

Ragip Xhaka: Fillimisht ju falënderoj për intervistën! ‘Epoka e re’ është një gazetë e cila me informimin e saj korrekt dhe profesional, gjithmonë është afër qytetarëve, në veçanti është afër mërgatës sonë anekënd ku janë shqiptarët. Të jesh babai i Granitit dhe Taulantit nuk është vetëm nder dhe privilegj, por është edhe përgjegjësi në vete. Ata, ashtu siç janë të përkushtuar në sport, ashtu janë të përkushtuar edhe për hallet e

vendlindjes së tyre dhe janë shumë të interesuar që edhe në Kosovë punët të shkojnë për mbarë. Në veçanti janë të interesuar në çështjet sportive, që edhe shqiptarët, në veçanti Kosova, të arrijë sa më lart në të gjitha fushat e sportit, me theks në futboll. Graniti dhe Taulanti kanë shumë adhurues. Përveç zvicëranëve, në veçanti adhuruesit e tyre janë shqiptarët. Sa herë që i takoj simpatizuesit e tyre, çdoherë marrë lëvdata për ta, gjë që kjo natyrisht më bën krenar, njëkohësisht na jep edhe një shtytje më tepër për të arritur suksese sa më të mëdha.

“Epoka e re”: Sa jeni i kënaqur me rezultatet e Taulantit dhe të Granitit me paraqitjen e tyre?

Ragip Xhaka: Çdo prind ka dëshirë që fëmijët e tyre t’i

arrijnë majat e suksesit në çdo fushë. Edhe unë dëshiroj që Graniti dhe Taulanti të jenë sa më lart në fushën e futbollit. Për sukseset e tyre jo vetëm unë, por besoj që janë krenarë të gjithë shqiptarët dhe vendet ku ata i përfaqësojnë. Tani së fundmi Graniti është zgjedhur edhe sportisti i vitit në Zvicër, çmim që natyrisht i bën të ndihen mirë që të gjithë.

“Epoka e re”: Z. Xhaka, keni vuajtur disa kohë edhe në burgjet e Serbisë. Si e vlerësoni situatën politike aktuale sot në Kosovë? Pritjet tuaja nga qeveria aktuale dhe të ish-bashkëvuajtësve tuaj të asaj kohe me të cilët bisedoni për qeverisjen e sotme?

Ragip Xhaka: Në Kosovë çdo gjeneratë ka sakrifikuar për lirinë

e Kosovës. Edhe unë kisha fatin që qelitë e burgut t’i ndaja me shumë bashkëpatriotë. Vlerësoj se munda nuk na ka shkuar kot dhe kjo kulmoi me lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, falë atyre gjeneratave, në veçanti gjeneratës së luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo gjeneratë krijoi një rrethanë të re kombëtare, politike dhe ekonomike. Me një fjalë, kjo gjeneratë vuri themelet e shtetësisë së Kosovës. Sa i përket qeverisjes aktuale, ajo lë shumë për të dëshiruar në të gjitha fushat, në veçanti gjendja aktuale me të cilën përballen bashkatdhetarët tanë kudo që janë.

“Epoka e re”: Mërgata shqiptare sa herë që Kosova ka pasur nevojë për ndihmë i ka zgatur dorën, si me “Fondin e 3%-shit”, me Fondin “Vendlindja Thërret” dhe me iniciativat e tjera. Mund të na thoni, sa ka qenë e organizuar në aspektin politik në atë kohë dhe si është e organizuar sot mërgata jonë?

Ragip Xhaka: Ne si mërgatë vetëm kemi bërë detyrën ndaj vendit ashtu siç e ka obligim çdo shqiptar aty ku jeton. Të bëj më të mirën për vendin e tij, nëse është e nevojshme, deri në flim. Mërgata shqiptare ndër breza të tërë gjithmonë ka qenë e

organizuar dhe është munduar ta bëjë më të mirën për Kosovën. Shumë nga ta që ishin të organizuar në mërgatë sot janë heronj të atdheut. Sot mërgata jonë konsideroj se është e organizuar, por Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet shumë më tepër për të bashkërenduar punët me mërgatën shqiptare si në aspektin politik, ekonomik dhe kulturor, të cilën nuk po e bën.

“Epoka e re”: Në Zvicër jeni zgjedhur kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, Dega në Zvicër. Mund të na thoni pse zgjodhët PDK-në dhe jo një parti tjetër?

Ragip Xhaka: Tani po bëhen dy vjet që jam zgjedhur kryetar i PDK-së, Dega në Zvicër. Në Degën e PDK-së në Zvicër janë njerëz të përkushtuar që i kanë shërbyer vendit me vite të tëra. Vlen të theksohet angazhimi i të rinjve të cilët kanë studiuar dhe studiojnë në universitetet e ndryshme të Zvicrës. Dhe kur thoni pse zgjodhët PDK-në, jua them me bindje se dua të përmbyll një kapitull të jetës time, atë të funksionalizimit sa më të mirë të shtetit të Kosovës. Dhe kush mund dhe di të bëjë këtë më mirë se PDK-ja. Deri më tani PDK-ja qëndron në krye të kësaj.

“Epoka e re”: Në qendrën e paraburgimit në Hagë po mbahen drejtuesit kryesorë të UÇK-së. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi e të tjerët. A po dëmtohet lufta e UÇK-së dhe Kosova me gjykimin e tyre?

Ragip Xhaka: Po bëhen disa vjet që ish-drejtuesit kryesorë të luftës së lavdishme të UÇK-së, njëkohësisht edhe drejtues kryesorë të shtetit të Kosovës, padrejtësisht po mbahen në paraburgim. Të gjithë këta emra janë sinonim i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. E në veçanti lirisht mund të them se janë edhe emra të përveçëm në historinë e ndërtimit dhe zhvillimit të Kosovës. Askush nuk ka fuqi ta dëmtojë dhe njollojë luftën e lavdishme të UÇK-së. UÇK-ja është projekti më i madh ndër dekada ndër shqiptarë.

“Epoka e re”: Ju i keni vizituar në Hagë. Na rrëfeni ndonjë çast të bisedës me ta. Si ndiheshin, çfarë ju thanë?

Ragip Xhaka: Po, i kam vizituar. Ata janë më të qëndrueshëm si asnjëherë më parë. Janë shumë të qetë në këtë proces. Porosia e tyre është që ne duhet të vazhdojmë, të mos ndalemi. Një punë e lënë në gjysmë është më keq se hiç. Kjo është porosia e tyre. Kjo na motivon të vazhdojmë përpara.

“Epoka e re”: Kush më shumë prej tyre po i mungon sot Kosovës?

Ragip Xhaka: Natyrisht që i mungojnë të gjithë. Përveç familjeve dhe miqve, më së shumti i mungojnë Kosovës. Atje po mbahet lidhshipi i PDK-së. Dhe natyrisht që kjo na ka dëmtuar. Por, edhe kësaj radhe do të dalim faqebardhë ashtu siç kemi dalë gjithmonë.

“Epoka e re”: PDK-ja në diasporë, veçanërisht në Zvicër, është duke themeluar nëndegë në disa kantone. Kush po i “ringjall” simpatizantët e saj. A ka prej tyre që e kanë votuar



Lëvizjen Vetëvendosje dhe që tani janë zhgënjyer apo, siç themi ne, i kanë rënë pishman?

Ragip Xhaka: PDK-ka tashmë është duke vazhduar fuqishëm organizimin e saj. Lirisht mund të them që PDK tani jo vetëm që ka shtrirje në të gjitha kantonet e Zvicrës, por është e pranishme në të gjitha qytetet e Zvicrës falë punës së palodhshme të shumë aktivistëve të PDK-së. PDK-ja do të rikthehet fuqishëm jo vetëm në diasporë, por edhe këtu brenda në Kosovë. Po, ka edhe nga ata që kanë votuar LV-në në zgjedhjet e kaluara. Por, ata tashmë e kanë kuptuar manipulimin e tyre që ka bërë LV, në veçanti me mërgatën. Asnjë nga premtimet e tyre elektorale nuk i kanë përmbushur. Përkundrazi, ankesat e bashkatdhetarëve tanë janë shumë të mëdha, në veçanti me problemet me të cilat përballen ata. Siç janë çështja e rregullimit të dokumenteve personale nëpër ambasada dhe konsullata. Jo vetëm këto, bashkatdhetarët

tanë janë shumë të shqetësuar për problemet me të cilat është duke kaluar Kosova.

“Epoka e re”: Z. Xhaka, sipas disa aktiviteteve që jua kemi përcjellë dhe publikuar në gazetë, kemi vënë re se jeni duke dhënë kontribut të madh në riorganizimin e PDK-së në Zvicër. Cila moshë dhe gjini po ju mbështet më shumë?

Ragip Xhaka: PDK-ja fuqishëm po organizohet jo vetëm në Zvicër, por kudo ku ekziston mërgata jonë. Kontributi im në fuqizimin e PDK-së në përgjithësi dhe në mërgatë në veçanti ka edhe meritat e bashkëpunëtorëve të mi si dhe të gjithë atyre aktivistëve të palodhshëm. Dua ta shfrytëzoj rastin t'i falënderoj përmes kësaj interviste. Neve si PDK në veçanti na përkrahin të gjithë. Ka një ndërlidhje brezash.

“Epoka e re”: Viti i ardhshëm është vit zgjedhor, fillon përgatitja për zgjedhjet

parlamentare. Sa është përgatitur PDK-ja në diasporë për këto zgjedhje?

Ragip Xhaka: Siç thashë, PDK-ja në Zvicër tani më është e shtrirë në të gjitha kantonet dhe qytetet e Zvicrës. Çdo ditë anëtarësohen dhe angazhohen njerëz të rinj. Kjo na obligon edhe më tepër që të punojmë dhe të angazhohemi në çdo moment. Jua them me bindje që PDK është shumë e përgatitur për fitore. Edhe ashtu ky pushtet e ka tepruar me demagogji dhe manipulime të masave. Është koha që vendin ta qeverisin ata që dinë dhe e duan Kosovën. E këtë natyrisht askush nuk mund ta bëjë më mirë se PDK-ja.

“Epoka e re”: A ka dëshpërim të votuesve të diasporës në qeverinë Kurti? Kah është orientimi i tyre sot për votim?

Ragip Xhaka: Një fjalë e urtë popullore thotë: “Shtrenjtë të bleva, por lirë më dole”. Dhe kjo i shkon shumë për shtati qeverisë aktuale. Shumica e tyre në

mërgatë, sikurse në Kosovë, tashmë e kanë kuptuar se nga kjo qeveri nuk ka asgjë të mirë për Kosovë. Këta do të mbahen mend vetëm për një gjë: dëmtim të shtetit të Kosovës dhe polarizim të shoqërisë. Po e them edhe njëherë, në kontaktet tona të përditshme me mërgatën tonë, ne kemi një përkrahje të fuqishme.

“Epoka e re”: Deri më sot asnjë veprimtar politik nga mërgata nuk është bërë deputet. A keni menduar të kandidoni?

Ragip Xhaka: Për kandidimin tim të mundshëm do të vendoset në forumet e partisë.

“Epoka e re”: Nëse kandidoni dhe zgjedheni deputet, çfarë shqetësime të mërgatës do të shprehni në Kuvend?

Ragip Xhaka: Siç thashë, për kandidimin tim të mundshëm do të vendoset në forumet e partisë. Por, nëse zgjedhem deputet, ju garantoj se do të jem një urë lidhëse në mes të mërgatës dhe Kuvendit të Kosovës. Askush më mirë se ne nuk i kupton hallet dhe problemet e mërgatës, sepse ne jetojmë çdo ditë me hallet e tyre. Ka shumë gjëra për të cilat duhet ta ngrehim zërin tonë.

“Epoka e re”: Z. Xhaka, suksese në jetën tuaj politike! Suksese djemve tuaj, Taulantit dhe Granitit, që na bëjnë krenarë në çdo paraqitje në ndeshje futbollit e pas çdo ndeshje futbollit.

Ragip Xhaka: Konsideroj se çdo shqiptar që jeton në vend të huaj të jetë shembull i mirë për rrethin dhe komunitetin ku jeton. Në veçanti kam një porosi për të rinjtë dhe të rejtat që duan ta ndjekin rrugën e Taulantit dhe Granitit. Pavarësisht prej pengesave që ju dalin, mos u dorëzoni. Me punë dhe përkushtim mund të arrini majat e suksesit. Faleminderit për mundësinë!





INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (15)

Jasharët e kanë bërë atë që s'e ka bërë askush gjer më sot!

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së pesëmbëdhjetë, ka folur për sulmin e forcave të armatosura serbe në Drenicë dhe Epopenë e UÇK-së. Ai ka folur edhe për sensibilizimin e opinionit publik ndërkombëtar për domosdoshmërinë e mbështetjes së luftës çlirimtare të Kosovës. "Krimet monstruoze që kryen forcat serbe në Likoshan, Qirez dhe Prekaz, ku u vranë mbi 80 shqiptarë, zunë vend në mediet më prestigjioze botërore", ka treguar Bardhyl Mahmuti, i cili në vazhdim të kësaj interviste ka folur edhe për deklaratën e Grupit të Kontaktit për Kosovën.

PRISHTINË, 17 DHJETOR - "Epoka e re": Përderisa kryesia qendrore e LPK-së nuk e përmendi sulmin e forcave të armatosura serbe në Drenicë dhe Epopenë e UÇK-së, na intereson të dimë si vepruan strukturat e tjera të organizatës suaj?
Bardhyl Mahmuti: Më 28 shkurt dhe 1 mars të vitit 1998 forcat e armatosura të Serbisë vranë 24 civilë në fshatrat Likoshan dhe Qirez të komunës së Skenderajt, në mesin e të cilëve ishte edhe një grua shtatzënë, Rukie Nebihu (27 vjeçe).

Pa pritur vendimin e Kryesisë së Degës së LPK-së, kryesitë e nëndegëve të saj organizuan dhjetë tubime dhe proteste në Gjermani, në Zvicër, në Francë, në Britani të Madhe dhe në disa shtete të tjera Evropë perëndimore. Në numrin e 5 marsit 1998 dhe të 12 marsit 1998 e përjavshmeja "Zëri i Kosovës", që ishte organ i LPK-së dhe e vetmja gazetë në gjuhën shqipe që përkrahte tërësisht luftën çlirimtare, i dha një hapësirë të konsiderueshme fillimit të zbatimit të gjenocidit të Serbisë në Kosovë

dhe mobilizimit të parë të shqiptarëve.

Krimi në fshatrat Likoshan dhe Qirez kishte karakteristika të një akti gjenocidal, ndërkaq përmasat e mobilizimit të forcave serbe në Drenicë ishin paralajmërime të qarta të fillimit të zbatimit të projektit të gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës. Më 2 mars 1998 Nëndega e LPK-së për Zvicër organizoi një protestë përpara selisë së Kombeve të Bashkuara në Gjenevë për ta shprehur revoltën





tonë dhe, njëherësh, t'i alarmonim institucionet ndërkombëtare për rreziqet që i kanoseshin shqiptarëve të Kosovës nga Serbia. Në konsultim me Jashar Salihun, Ramadan Avdiun, Bilall Sherifin dhe Agush Bujën vendosëm që, në të njëjtën kohë që përpara selisë së OKB-së protestonim mbi 10 mijë shqiptarë, të organizonim një konferencë me gazetarët e akredituar në selinë e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë. Në marrëveshje me veprimtarët e lartpërmendur, vendosëm që në këtë konferencë të shkonim vetëm unë dhe Jashar Salihu, hero i kombit, i cili në atë kohë ishte anëtar i Sektorit të Veçantë dhe përgjegjës i fondit "Vendlindja thërret".

politikën e gjenocidit kanë qenë të sakta por, fatkeqësisht, aktorët me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk kanë qenë efikas në parandalimin e krimit të gjenocidit në Kosovë.

"Epoka e re": *Revolta e përgjithshme e shqiptarëve që u manifestua në protesta të shumta që u organizuan në katër anët e globit nuk e ndali dhunën serbe. Serbia vazhdoi projektin e gjenocidit kundër shqiptarëve! Është e pakuqteshme heshtja e Kryesisë së LPK-së dhe atyre që kishin shkruar komunikatat e lartpërmendura në emër të Shtabit Qendror të UÇK-së!*
Bardhyl Mahmuti: Katër ditë pas krimit të gjenocidit në fshatrat

Jashari, 85 vjeçe). Redaksia e atëhershme e gazetës "Zëri i Kosovës" (Bislim Elshani, Lulëzim Etemaj, Adnan Asllani etj.) doli me një shkrim redaksional në të cilin rezistenca e armatosur në Prekaz u cilësua "Epopë e lavdishme e Jasharjave", ndërsa duke e krahasuar me epopetë e njohura kombëtare, ata erdhën te konkluzioni: *Jasharajt e kanë bërë atë që s'e ka bërë askush gjer më sot!*

Në të njëjtën frymë u publikuan shkrime nga Bedri Islami, anëtar i Kryesisë së Nëndegës së LPK-së për Gjermani dhe publicist i njohur, Mehmet Bislimi, anëtar i Kryesisë së Nëndegës së LPK-së

"Epoka e re": *Vrasja e civilëve shqiptarë në fshatrat Likoshan dhe Qirez ishte krimi më i rëndë që Serbia kishte kryer që nga koha e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Më vonë u pa qartë se këto vrasje shënuan aktin e parë gjenocidal të luftës së fundit në Kosovë. A përdorët termin gjenocid në këtë konferencë, apo nga perspektiva e tanishme ju e cilësoni si të tillë?*
Bardhyl Mahmuti: Për ne ishte e qartë se kishim të bënim me një akt gjenocidal, ndërkaq përmasat e mobilizimit të forcave të armatosura serbe linin të nënkuptohej se projekti i Serbisë ishte shkatërrimi i tërësishëm ose i pjesëshëm i shqiptarëve në Kosovë. Pikërisht për këtë arsye gjatë konferencës kërkua nga gazetarët e pranishëm ta sensibilizonin opinionin publik të shteteve të tyre për domosdoshmërinë e mbështetjes së luftës çlirimtare të Kosovës,



LONDON CONTACT GROUP MEETING, 9 MARCH 1998
STATEMENT ON KOSOVO
 1. We the Foreign Ministers of Contact Group countries, together with representatives of the European Commission and the Office of the High Representative, met in London on 9 March to discuss the increasingly tense situation in Kosovo, Federal Republic of Yugoslavia (FRY), and the unacceptable use of force over recent days. The Balkans region has seen too much bloodshed in recent years for the international community to stand aside.
 2. We recalled that when we met in New York on 24 September 1997, we voiced deep concern over developments in Kosovo and called on the authorities in Belgrade and the leadership of the Kosovar Albanian community to join in a peaceful dialogue. We are dismayed that in the period since September, rather than taking steps to reduce tensions or to enter without preconditions into dialogue toward a political solution, the Belgrade authorities have applied repressive measures in Kosovo. We note with particular concern the recent violence in Kosovo resulting in at least 40 fatalities and condemn the use of excessive force by Serbian police against civilians, and against peaceful demonstrators in Pristina on 2 March.

sepse indiferenca ndaj Serbisë trimëronte vazhdimin e politikës së gjenocidit ndaj shqiptarëve. Po ju bashkëngjis për lexuesin njoftimin që kishte përgatitur Zikpress dhe që është botuar në "Zëri i Kosovës" më 5 mars 1998.

Likoshan dhe Qirez, projekti serb për gjenocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës vazhdoi në Prekaz të komunës së Skenderajt. Gjatë qëndrësës heroike të familjes Jashari më 5, 6 dhe 7 mars u vranë 59 shqiptarë të dy gjinive dhe të moshave të ndryshme (më i riu ishte Blerim Jashari, 5 vjeç, ndërsa më e moshuara, Hamide

për Zvicër dhe shkrime të tjera! Cilësimi i qëndrësës së Jasharëve si epope mori përmasa të përgjithshme dhe u shndërrua në Epope të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me një fjalë, kryesitë e nëndegëve të LPK-së dhe redaksia e "Zërit të Kosovës" që ishte organ i Lëvizjes Popullore të Kosovës na shpëtuan nga sjellja e turpshme e kryesisë qendrore të LPK-së!



datës 31 mars 1998.

"Epoka e re": *Në Deklaratën e Grupit të Kontaktit të datës 9 mars, në qëndrimin e përbashkët të BE-së, të datës 19 mars, dhe në Rezolutën 1160 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 31 mars, Ushtria Çlirimtare e Kosovës cilësohet si organizatë terroriste. Si e shpjegoni këtë çështje?*

Bardhyl Mahmuti: Legjitimimi i një luftime armatosur në skenën politike ndërkombëtare nuk është i lehtë. Qëndrimet e lartpërmendura janë dëshmi të vështirësive të mëdha me të cilat jemi ballafaquar. Nuk ka ndonjë peshore objektive që do të na mundësonte të vlerësonim deri në cilën masë kemi përgjegjësi si organizatë për një cilësim të tillë. Por janë fakte se nga



9. No one should misunderstand our position on the core issue involved. We support neither independence nor the maintenance of the status quo. As we have set out clearly, the principles for a solution of the Kosovo problem should be based on the territorial integrity of the Federal Republic of Yugoslavia, and should be in accordance with OSCE standards, Helsinki principles, and the UN Charter. Such a solution also must take into account the rights of the Kosovo Albanians and all those who live in Kosovo. We support an enhanced status for Kosovo within the FR Y which a substantially greater degree of autonomy would bring and recognize that this must include meaningful, self-administration.

momenti kur përfaqësimi politik i UÇK-së është bërë në emër të Drejtorisë Politike gjërat kanë ndryshuar për mirë! Brenda gjashtë muajsh aktivitetet në ngjeshura diplomatike, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës iu hoq cilësimi "organizatë terroriste". Në vend që të jenë të kënaqur të gjithë veprimtarët e LPK-së për këto rezultate, na i kanë shurdhuar veshët me pyetje: Kush është takuar me amerikanët në emër të UÇK-së? Çfarë është biseduar në ato takime? Kush e ka zgjedhur Drejtorinë Politike? dhe pyetje të tjera të kësaj natyre. Të gjithë ata që këtyre pyetjeve u kanë gjetur shpjegim në interpretimin e proceseve shoqërore nëpërmjet "komplotit", do të kenë përgjigjen time të plotë në vazhdim të intervistës. Tani për tani po ju them shkurtimisht: jam tepër i lumtur që nuk jam zgjedhur ta përfaqësoj Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës nga ata që nuk e përmenden Epopenë e Jasharëve dhe heroizmin e Komandantit Legjendar Adem Jashari!
(Muhamet Mavraj / Vijon)

Në vitin 2024 do të bie inflacioni në Kosovë, jodomsdoshmërisht edhe çmimet

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Në raportimet zyrtare këtë vit inflacioni ka rënë, por jo edhe për kuletat e qytetarëve. "Ky vit ka qenë mjaft i vështirë për të siguruar para për blerjen e produkteve elementare... Nuk pres asnjë ndryshim vitin tjetër", thotë Mentor Berisha nga Prishtina.

Edhe për bashkëqytetarin e tij Gafurr Kuqi "gjithçka ka qenë më shtrenjtë, pemët, perimet, të gjitha". Të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës janë për nëntorin dhe, sipas tyre, inflacioni në atë muaj ka qenë 2.9 për qind, në tetor ka qenë 3.3 për qind, në shtator 4.2 për qind.

Për krahasim, vitin 2022 Kosova e ka mbyllur me shkallë mesatare inflacioni gati 12 për qind.

Normës së rritjes së çmimeve - siç njihet inflacioni ndryshe - i ka dhënë shtytje pandemia e koronavirusit në vitin 2020/21, pastaj edhe pushtimi rus i Ukrainës më 2022. Por, gjatë këtij viti, shumica e vendeve kanë raportuar rënie të inflacionit - kryesisht për shkak të stabilizimit të zinxhirit të furnizimeve.

Rënia e inflacionit nuk do të thotë

edhe rënie e çmimeve, por do të thotë se çmimet rriten më ngadalë. Vetëm herë pas here ato mund të bien pak në krahasim me muajin paraprak.

Gjatë këtij viti REL-i ka raportuar disa herë për çmimet e larta në Kosovë dhe rritjen e vazhdueshme të tyre.

Në mars çmimi i miellit ka rënë, por jo edhe i bukës. Sipas raportimit të atëhershëm, zbritja e çmimit të bukës nuk ka mundur të bëhet për shkak të shtrenjtimit të rrymës dhe të fuqisë punëtore.

Në korrik disa qytetarë që i ka anketuar REL-i kanë thënë se e kanë të vështirë të bëjnë pushime për shkak të shtrenjtimit të produkteve bazë dhe shërbimeve. Ndërsa në shtator perimet për turshi kanë qenë "të paprekshme". "Vitin e kaluar, nëse i ke marrë specat me thes [3 kilogramë], kanë kushtuar prej 1.5 deri në 1.8 euro. Sivjet 3 euro e gjysmë është thesi i njëjtë, me kilogramë të njëjtë. Domatet... vjet i kemi marrë 60 deri në 70 centë për kilogram, sivjet i ke 1.2 deri në 1.5 euro", ka treguar atëkohë Amir Simnica, blerës në Tregun e Gjellbër në Prishtinë.

Ekspertët thonë se konsumatorët nuk ndiejnë lehtësim të menjëhershëm edhe kur norma e inflacionit ngadalësohet, sepse shumë prej çmimeve të ngritura mbeten ashtu. Derisa pagat nuk e arrijnë inflacionin, ai do të vazhdojë të rëndojë, sipas tyre.

Në Kosovë paga mesatare është 520 euro, ndërsa minimalja sillet nga 130 deri në 170 euro, e pandryshuar qysh nga viti 2011.

Blendi Hasaj nga Instituti për Hulumtime të Avancuara GAP në Prishtinë thotë se në bazë të analizave që ka bërë një familje që i ka shpenzuar 500 euro gjatë një muaji në vitin 2021, gjatë vitit 2022 është dashur ta rrisë këtë buxhet për rreth 60 euro. Ndërsa gjatë vitit 2023 shuma që është shpenzuar në vitin 2021 është dashur të rritet për 80 euro "për t'u konsumuar sasia e njëjtë e produkteve sikurse në vitin 2021".

Cilat janë parashikimet për 2024?

Parashikimet e Bankës Qendrore Evropiane janë se shkalla e

inflacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor do të jetë 3 për qind në vitin 2024.

Ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, parashikon që Kosova ta përmbyllë vitin 2023 me normë mesatare inflacioni 5.4 për qind.

Në janar të këtij viti, derisa ka qenë në krye të BQK-së, Mehmeti ka parashikuar rënie të inflacionit deri në 6 për qind në gjashtëmuajorin e dytë të 2023-shit. "Pritjet janë që në vitin e ardhshëm [2024] inflacioni vjetor, për afërsisht, të jetë rreth 3.6 për qind. Vetëm në vitin 2025 presim të kemi një inflacion prej 2-përqindësh", thotë Mehmeti për REL-in. Sipas tij, energjia elektrike është një ndër produktet që është shtrenjtuar më së shumti dhe efekti, pastaj, ka qenë zinxhiror. "Ne te gjithë jemi familjarë dhe e dimë se çfarë kemi blerë me 100 euro para pandemisë... tani duhet shumë më shumë para për ta mbushur shportën e konsumit. Kemi inflacion më të lartë te produktet bazë", thotë Mehmeti.

Duhet kujtuar se çmimet vitin e kaluar kanë marrë hov kryesisht nga çmimet globale të energjisë. Analiza të ndryshme thonë se ato do të bien - jo sa kanë qenë para pushtimit rus të Ukrainës - por se çdo rënie e çmimeve të energjisë do të marrë kohë për t'u vërejtur në ekonominë e gjerë.

Ekspertët, po ashtu, tërheqin vërejtjen se rënia e çmimeve nuk do të ishte domosdoshmërisht gjë e mirë, pasi do të sinjalizonte një ekonomi të dobët, me zvogëlim të produktivitetit.

Inflacioni negativ ose deflacioni ka të ngjarë të çojë, pastaj, në rritje të konsiderueshme të papunësisë dhe ulje të pagave.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, papunësia në vend sillet në më pak se 12 për qind.

Të dhënat e publikuara nga ASK-ja në fund të shtatorit treguan se pjesa më e madhe e buxhetit familjar në Kosovë u nda për blerjen e artikujve ushqimorë. Sipas ASK-së, familjet e Kosovës shpenzuan rreth 300 për qind më shumë para për ushqim sesa për banim vitin e kaluar.



Gërxhaliu: Buxheti për vitin 2024, më shumë zgjedhor sesa zhvillimor

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Buxheti për vitin 2024, i cili u miratua nga shumica parlamentare të enjten, është më shumë zgjedhor sesa zhvillimor, sipas njohësi të ekonomisë, Safet Gërxhaliu.

Deputetët e mazhorancës kanë miratuar buxhetin për vitin e ardhshëm, që kap vlerën mbi 3.3 miliardë euro. Partitë opozitare nuk e kanë përkratur atë pasi,



sipas tyre, nuk është buxhet i mirëqenies qytetare. Ndërkaq kreu i ekzekutivit, Albin Kurti, ka thënë se buxheti i miratuar është për 35 për qind më i lartë se ai aktual.

Por, i një mendimi me opozitën është edhe Gërxhaliu, i cili në një prononcim për "Telegraf"-in tha se ky buxhet është i orientuar në politikë sociale. "Shqetësuese në

Kosovë është mungesa e një dialogu të mirëfilltë, qoftë në mes të pozitës dhe opozitës, qoftë nga niveli qendror me atë lokal, e qoftë partneriteti publiko-privat. "Vetë fakti që sot qeveria aktuale e ka shumicën, është ditë që ky ligj do të kalojë, mirëpo ky buxhet nuk mund të jetë zhvillimor. Është shumë më tepër i orientuar në politikë sociale", u shpreh ai.

Marcus Aurelius: Filozofia e një Perandori

Në mesin e fushatave brutale kundër popujve gjermanikë të Danubit, perandori Marcus Aurelius shkroi një sërë reflektimesh, që e vendosën atë në mesin e mendimtarëve më me ndikim të lashtësisë.

Në shekullin e dytë pas Krishtit, bota e perandorit Marcus Aurelius ishte në rrënim. Një murtajë e madhe shkatërroi Evropën perëndimore, ndërsa ai filloi një luftë të gjatë dhe të përgjakshme kundër fiseve gjermane përgjatë kufirit të Danubit. Përballë këtyre fatkeqësive, bashkë me pleqërinë dhe mendimet për vdekjen, perandori kërkoi ngushëllim tek filozofia.


Gjatë gjithë jetës së tij, veçanërisht në momente të çuditshme gjatë fushatës ushtarake, ai hodhi në letër betejat e tij personale, bindjet filozofike dhe njohuritë për të qenë një sundimtar dhe një person më i mirë. Nga kjo shprehje e sinqertë e introspeksionit dolën 12 libra që merren me jetën dhe gjendjen njerëzore. Në total ky koleksion quhet Meditimet.

Filozofi Perandor

I lindur në vitin 121 në një familje aristokrate në Romë, Marcus Aurelius mori një arsimim të shkëlqyer në retorikë dhe filozofi. Ai studioi greqisht dhe sidomos Homerin dhe Euripidin. Ndoshta kjo është arsyeja pse ai i shkroi Meditimet në greqisht dhe jo në latinisht, gjuha zyrtare e Perandorisë Romake.

Në moshë të re, ai u interesua gjithashtu për filozofinë, veçanërisht stoicizmin, një shkollë mendimi që lulëzoi në antikitet. Një nga parimet kryesore të tij thekson zhvillimin e forcës së brendshme dhe pranimin e atyre gjërave që janë jashtë kontrollit tënjeriut. E themeluar në Athinë nga Zeno i Citiumit, rreth vitit 300 p.e.s., stoicizmi u rrit për t'u bërë një nga filozofitë kryesore të botës së lashtë.

Ai lulëzoi në Romën e lashtë, me Ciceronin ndër studiuesit e tij kryesorë (dhe një burim i mirë informacioni mbi stoicizmin në Romë). Epikteti, një grek i skllavëruar më parë, u bë filozof stoik me shumë ndikim i studiuar nga Marcus Aurelius. Në fakt, Meditimet kanë disa ngjashmëri me koleksionin e parimeve morale të Epiktetit, të quajtura Enchiridion (Manual). Por vepra e Marcus Aurelius-it i shton zërin e tij origjinal traditës filozofike të stoicizmit. Ai i shtoi peshë kësaj shkolle të mendimit dhe arriti të besojë se perceptimi është baza e njohurive të vërteta.



Lumturia mund të gjendet nëpërmjet praktikës së virtutit dhe të udhëhequrit në çdo kohë nga arsyeja, përballë peripecive të jetës.

Besohet se Marcus Aurelius i shkroi Meditimet si një formë introspeksioni dhe jo për konsum më të madh publik. Ato variojnë nga maksimat e hapura deri te disertacionet bindëse dhe nuk ka një organizim definitiv të veprës – megjithëse disa modele janë identifikuar, me tema të organizuara rreth filozofisë stoike.

Me mirënjohje

Vepra nis si një lloj rrëfimi, në të cilin Marcus Aurelius falënderon të gjithë ata që ndikuan pozitivisht gjatë gjithë jetës së tij. Për shembull, ai vlerëson mësuesit e tij që e mbajtën larg nga besëtytnitë dhe veset dhe e kthyen drejt një jete më të mirë e të virtutshme. Më i rëndësishmi nga këta mësues, kujton ai, ishte Quintus Junius Rusticus, i cili korrigjoi karakterin e tij të vrullshëm dhe e prezantoi me filozofët stoikë.

Marcus Aurelius kujton gjithashtu jetën e tij në oborrin e Romës, ku mbërriti në moshën 17-vjeçare. Babai i tij birësues, perandori Antoninus Pius, kishte një mënyrë jetese modeste, dhe kështu i riu Marcus Aurelius nuk hyri në një botë veshjesh dhe jetese luksoze; ai nuk kishte as roje personale. Perandori i ardhshëm admiroi përkushtimin me të cilin babai i tij birësues drejtoi perandorinë dhe personalitetin e tij të qetë, por të vendosur.

Marcus Aurelius u ngjiti në fron në vitin 161, duke bashkëqeverisur me vëllanë e tij birësues Lucius Verus deri sa

vdiq Luciusi, në vitin 169. Ndërsa Marcus Aurelius nuk reflekton drejtpërdrejt për jetën e tij si perandor, ai prek tema të rëndësishme të lidhura me të, duke përfshirë peshën e përgjegjësive dhe nevojën për të respektuar drejtësinë. Ai pranon se duhet të marrë vendime në interesin më të mirë të njerëzve që qeveris. Ai shkruan: "Filloni çdo ditë duke i thënë vetes: Sot do të ndeshem me ndërhyrje, mosmirënjohje, pafytyrësi, pabesi, keqdashje dhe egoizëm... Asnjë nga këto gjëra nuk mund të më lëndojë, sepse askush nuk mund të më implikojë në atë që është poshtëruese".

Ai pranon se pushteti mund të jetë një barrë dhe një tundim, duke theksuar rëndësinë e shmangies së arrogancës dhe ruajtjes së përunjësisë përballë autoritetit. Ai gjithashtu ofron njohuri se si të përballeni me situata të vështira, të ruani qetësinë e brendshme dhe të qëndroni të fokusuar në qëllimin tuaj, përballë pengesave.

Ndër vëzhgimet e tij më personale janë gjërat që duket se e shqetësojnë. Ai e pranon se e urren atë që shumica e qenieve njerëzore duket se e duan. Lojërat e gladiatorëve, për shembull, e neverisin; seksi reduktohet në "një kënaqësi të shkurtër". Dhe ai nuk e kupton pse njerëzve u bëjnë përshtypje rrobat e purpurta të veshura nga senatorët dhe perandorët, kur këto janë thjesht "lesh delesh i lyer me gjak butaku".

Ai përpiket të qëndrojë i qetë në çdo moment dhe të mos shqetësohet me atë që fqinj i tij do të thotë, ose do të mendojë për të. Siç i kujton vetes: "Gjithmonë habitem: Ne të

gjithë e duam veten më shumë se njerëzit e tjerë, por na bëhet vonë më shumë për mendimin e tyre, sesa për tonin."

Familja luan një rol të vogël në shkrimet e tij, megjithëse ai është jashtëzakonisht mirënjohës për gruan, Faustinen e Vogël, vajzën e Antonius Pius. Ai e përshkruan atë si "aq të bindur, kaq të dashur dhe kaq të thjeshtë". Burimet e tjera bashkëkohore nuk ishin aq të sjellshme me Faustinen. Historianë si Cassius Dio e kanë akuzuar për tradhti bashkëshortore me ushtarë dhe gladiatorë të pashëm. Megjithatë, në shkrimet e tij, Marcus Aurelius ka vetëm fjalë të mira për të. Të dy kishin 13 fëmijë së bashku, por vetëm gjashtë jetuan pas fëmijërisë. Kur Faustina vdiq, në vitin 175, perandori u pikëllua për humbjen e saj. Ai varrosi gruan e tij në Mauzoleumin e Hadrianit në Romë.

Lufta dhe Vdekja

Duke shkruar natë pas nate nga kampi i tij ushtarak përgjatë Danubit, Marcus Aurelius kthehet në tema më të errëta, duke përfshirë natyrën e luftës. Në pika të ndryshme, ai vë në dukje realitetin e tmerrshëm të luftimit: "A keni parë ndonjëherë një dorë ose këmbë të prerë, ose një kokë të prerë, të shtrirë diku larg trupit të cilit dikur i përkiste...?"

Por kur dita mbaron, ato përsiatje zbehen dhe mbizotëron realiteti. Filozofi i natës, duhet të jetë një udhëheqës ushtarak ditën. Ai e pranon se nuk është gjithmonë e lehtë. "Në agim, kur e ke të vështirë të ngrihesh nga shtrati, thuaj vetes: 'Duhet të shkoj në

punë—si qenie njerëzore', edhe pse preferon që «të mblidhesh nën batanije».

Përgjatë Meditimeve, Marcus Aurelius përsërit, pothuajse deri në obsesion, idenë se të gjithë ndajnë përfundimisht të njëjtin fat në këtë jetë të shkurtër: vdekjen. "Jetët e njerëzve janë të shkurtra dhe të parëndësishme," shkruan ai.


Ka reflektime mbi gjeneralët e mëdhenj të së kaluarës, si Aleksandri i Madh, Çezari dhe Pompei, dhe se si, pavarësisht nga triumfet e tyre, "edhe ata u larguan nga kjo jetë". Gjithashtu përmenden edhe banorët anonimë të Pompeit dhe Herkulaneumit, që u mbytën nën hirin e malit Vezuv.

Mbi të gjitha, kërkimi më i madh i perandorit është të gjejë paqen e mendjes, ndërsa mediton se sa shpejt kalon jeta: "Ekzistenca na kalon si një lumë: "çfarë" është në rrjedhë të vazhdueshme, "pse" ka një mijë variacione." Ai thotë se rruga më e mirë është të "bëni gjithçka sikur të ishte gjëja e fundit që po bënit në jetën tuaj". E megjithatë, vdekja i ofron Marcus Aureliusit një lloj çlirimi, një shans për t'u shkëputur nga një botë ku shumë injorojnë të vetmet vlera që ai njeh – ato të virtutit racional dhe të së mirës morale. Drama e vërtetë e filozofit-perandor është se ai përpiket t'i dojë njerëzit e tjerë: "Gjërat e paracaktuara për ju – mësoni veten të jeni njësh me to. Dhe njerëzit që i ndajnë ato me ju – trajtojini me dashuri. Me dashuri të vërtetë."

Të gjitha këto Marcus Aurelius ia thotë vetes pa ankth apo dëshpërim. Edhe vdekja duhet pranuar me mirënjohje: "Mos e shikoni vdekjen me përçmim, por mirëpritni atë". Vdekja është pjesë e skemës natyrore të gjërave, mendon ai, duke e krahasuar atë me "një ulli që piqet dhe bie. Duke lavdëruar nënën, duke falënderuar pemën ku u rrit." Ai thotë të pranosh vdekjen "me gëzim dhe vërtetësi, mirënjohës ndaj perëndive nga thellësia e zemrës".

Kur Marcus Aurelius vdiq më 17 mars 180, në moshën 58-vjeçare, viktimë e murtajës, ai la pas një gjurmë të pashlyeshme. Shkrimet e tij kanë intriguar krerët e shteteve që nga Frederiku i Madh i Prusisë e deri te presidenti i SHBA Bill Clinton. Kur Wen Jiabao, kryeministri i Kinës midis 2003 dhe 2013, pretendoi se kishte lexuar Meditimet më shumë se njëqind herë, vepra u bë një nga klasikët grekë më të botuar në vend. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ylli fiton sfidën në Prizren, Prishtina mposhti Pejën

PRIZREN, 17 DHJETOR - Golden Eagle Ylli fiton sfidën ndaj Proton Cable Prizrenit me rezultat 71:92 (22:29, 24:20, 17:20, 8:23), në javën e 13-të të Prince Caffè Superligës, ndeshje që u vendos në dhjetë minutat e fundit. Çereku i parë u zhvillua me rikthime në rezultat, derisa në fund, therandasit e fituan këtë pjesë 22:29. Mysafirët në periudhën e dytë disa herë ishin në epërsi

deri në dhjetë pikë, sidoqoftë, prizrenasit nuk u dorëzuan dhe ngushtuan shifrat, ku pjesa e parë përfundoi 46:49. Lojë e barabartë u zhvillua edhe në periodën e tretë, që përfundoi me një shënim pothuajse nga koshi në kosh nga Jan Palokaj për 63:69. Në dhjetë minutat e fundit dhe vendimtare, Ylli bëri shkëputjen dhe menaxhoi lojën dhe epërsinë, për të

triumfuar 71:92. Te Proton Cable Prizreni më të mirët ishin Urim Zenelaj me 16 pikë e 12 kërcime dhe Isaiah Kelly me 21 pikë e pesë kërcime, kurse te Golden Eagle Ylli u dalluan Gëzim Morina dhe Chris Harris me 17 pikë e shtatë kërcime, Jalen Nesbitt me 15 pikë e nëntë kërcime dhe Dajuan Graf me 11 pikë, pesë kërcime e shtatë asistime. Prizrenasit kanë

katër fitore e nëntë humbje, kurse therandasit nëntë tetë fitore e pesë humbje. Në një sfidë dramatike, Sigal Prishtina ka triumfuar në derbin ndaj Pejës në udhëtim me rezultat 78:81 (19:26, 23:15, 20:23, 16:17), në javën e 13-të të elitës së basketbollit. Më i miri te pejanët ishte Justin Davis me 16 pikë e 13 kërcime, ndërsa te prishtinasit u dallua Shaheed Davis me 26 pikë e



pesë kërcime. Peja ka nëntë fitore e katër humbje, derisa Sigal Prishtina tetë fitore e pesë humbje.

Kosova rrëmben një medalje të artë dhe tri të bronzta në Kampionatin Evropian

"Epoka e re"

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Mbi 40 xhudistë nga 27 shtete të Evropës morën pjesë në Kampionatin Evropian të Xhudos që për herë të parë u organizua në Kosovë. Pallati i Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë ishte përplot me sportdashës që kishin ardhur të shohin xhudistët e tyre të preferuar të cilët kësaj radhe po garonin në shtëpinë e tyre. Në këtë kampionat xhudistët tanë dhanë emocion e krenari për të gjithë të pranishmit. Ata i sollën

shtetit katër medalje, Akili medalje të artë dhe Distria, Nora e Dardani të bronzit. Duke qenë ngjarja më e madhe e sportit të xhudos e organizuar ndonjëherë në Kosovë, u dëshmuar edhe njëherë që vendi ynë ka aftësi në organizim të ngjarjeve të tilla sportive. Ceremonia e hapjes së Kampionatit Evropian të Xhudos nisi me prezantimin e klipit "Kosova, shtet i xhudos" dhe me performancën e Ansambllit "Rugova". Të pranishëm në këtë ngjarje ishin presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti, ministri i Sportit, Hajrulla Çeku,

presidenti i Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka, zëvendës-presidenti i Federatës Evropiane të Xhudos, Otto Kneiting, përfaqësues të federatave sportive, ambasadorë të akredituar në Kosovë, ministra dhe deputetë. Akil Gjakova është shprehur i lumtur me medaljen e artë që fitoi në Kampionatin Evropian. "Nuk kam pasur kurrë një ditë më të mirë në xhudo. Të fitosh në shtëpi është e mrekullueshme.



Fansat, familja dhe miqtë më kanë dhënë forcë. Mendoj se kjo është arsyeja pse luftimet ishin relativisht të lehta për mua", ka thënë Gjakova për Unionin Evropian të Xhudos. "Mendoj se

isha edhe më i mirë se kur fitova titullin e Kampionatit Evropian në 2021. Mundja e Heydarov më jep shumë besim, veçanërisht duke shkuar në Lojërat Olimpikë 2024 në Paris". Si ka ndërmend të përdorë bonusin e fitores prej 55 mijë eurosh? "Është koha ideale për të falënderuar të gjithë njerëzit të cilëve ua kam borxh këtë sukses dhe do të të pak mënjani për të kursyer. Dhe ne do të arëtohem gjithashtu", ka deklaruar Gjakova.

Prishtina merr një pikë ndaj kampionit, Llapi fiton në Prizren

SUHAREKË, 17 DHJETOR - Prishtina ka vazhduar serinë e rezultateve pa humbje. Në kuadër të javës së 18-të në Albi Mall Superligë skuadra nga kryeqyteti ka arkëtuar një pikë në Suharekë në përballje me liderin dhe kampionin në fuqi, Ballkanin, duke mbyllur ndeshjen baras (0:0). Për skuadrën e drejtuar nga Emmanuel Egbo kjo është ndeshja e gjashtë pa humbje. Të dyja palët patën disa mundësi të mira shënimi, por golin ua mohoi traversa.



Ndërkohë, Llapi ka shfrytëzuar barazimin e Ballkanit, teksa ka fituar në stadiumin "Përparim Thaçi" në Prizren ndaj Lirisë, me rezultat 2:0. Muhamet Hyseni

shënoi golin e parë në minutën e 28-të pas një asistimi të shkëlqyer nga Ilir Blakçori, derisa golin e dytë e shënoi kapiteni Hamdi Namani, në minutën e 61-të. Tani skuadra e Tahir Batatinës ka vetëm pesë pikë ngecje ndaj Ballkanit, por skuadra portokallezi ka dy ndeshje më pak. Djelmoshat e Ilir Dajës të mërkurën do ta zhvillojnë ndeshjen e mbetur të javës së 3-të kundër Dritës në Gjilan, derisa në të njëjtin qytet do të udhëtojnë edhe të dielën e

ardhshme ku do të përballen me Gjilanin, në ndeshjen e mbetur të javës së 13-të. Ndërsa Malisheva ka befasuar Dritën, duke e mposhtur në Gjilan, me rezultat 2:1. Për Malishevën kjo ishte fitorja e nëntë në këtë edicion, duke e mbyllur kësaj stinorin vjeshtor në kuotën e 29 pikëve. Drita kaloi e para në epërsi me golin e pestë nga Blerim Krasniqi, mirëpo mysafirët reagueshan shpejt. Fillimisht Drilon Hazrollaj barazoi shifrat në minutën e 17-të, kurse

Altin Aliu me golin e shënuar në kohën shtesë së pjesës së parë vulosi fitoren e Malishevës. Fitore si mysafir ka realizuar edhe Feronikeli 74, që e ka mposhtur Fushë Kosovën në Lipjan, me rezultat 1:0. Golin e fitores për skuadrën nga Drenasi e shënoi Musa, në minutën e 9-të. Ndërkohë, Dukagjini ka shënuar fitore para tifozëve të vet në përballje me Gjilanin, po ashtu me rezultat 1:0, me golin e Nezirit, në minutat shtesë të ndeshjes.

Trepçës i takon derbi, Rahovecin regjistron fitoren e 14-të

Prishtinë, 17 dhjetor - Të dielën u luajtën tri ndeshjet e fundit të stinorit vjeshtor në Superligën e Kosovës në hendboll. Kryendeshjen e ditës e zhvilluan Prishtina e Trepça. Takimin e xhiros së 14-të, të zhvilluar në Bardhosh, e fituan mitrovicasit me rezultat 35:27. Prishtina nisi më mirë dhe ishte në epërsi deri në minutën e 12-të. Më pas në epërsi kaluan mitrovicasit

dhe pjesa e parë përfundoi 15:12 për Trepçën. Në pjesën e dytë mysafirët mbajtën vazhdimisht epërsi dhe në fund triumfuan me tetë gola dallim. Yassine Henahem e Shpëtim Mehmeti i kishin nga gjashtë gola për Trepçën. Pesë i shënoi Hamdi Salihu, ndërsa katër Sali Maxhera. U shqua sidomos portieri Liridon Esati me pritje të shumta. Te Prishtina, Albi Gjuka i shënoi shtatë gola, ndërsa Oltion

Beshiri gjashtë. Vladyslav Napadailov i kishte pesë gola, ndërsa Agon Bajqinovci katër. Trepça përfundon stinorin vjeshtor në pozitën e tretë me 20 pikë. Prishtina është e pesta me 14 pikë. Kampion vjeshtor është Rahoveci që i fitoi të gjitha 14 ndeshjet. Të dielën fitoi bindshëm ndaj Deçanit, 48:29. Alban Haziri i shënoi nëntë gola për Rahovecin, ndërsa shtatë i kishte Mali Luzha. Te Deçani,

Albion Loshaj e Florian Loshaj i kishin nga tetë gola. Rahoveci ka 28 pikë në vendin e parë, ndërsa Deçani është i gjashti me 6 pikë. Ndeshja tjetër e së dielës ishte ajo mes Vushtrrisë dhe Vëllaznimit. Vendasit fituan 32:30. Vushtrria ishte para në rezultat thajse gjatë gjithë ndeshjes dhe mori pikët e rëndësishme. Fitim Klinaku i kishte 11 gola, ndërsa dhjetë i shënoi Muhamet Hyseni. Te



Vëllaznimit, Ardi Halili realizoi dhjetë gola, ndërsa shtatë i kishte Arnis Spahija. Vushtrria është e shtata me katër pikë. Vëllaznimit mbetet me dy pikë në pozitën e tetë, përkatësisht të fundit.

